

SYLLABUS

Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës

LËNDA:	EKONOMIKSI I ZHVILLIMIT TË KOSOVËS
Niveli i kursit:	Master, Departamenti Ekonomiks
Lloji i kursit:	Obligative
Viti i studimeve	2017/2018
Semestri:	VIII
Kodi dhe shifra e lëndës:	
Koha/lokacioni:	Sipas orarit
Ligjëratat:	2 orë në javë
Mësimdhënësi i kursit:	Prof. Dr. Rahmije Mustafa- Topxhiu e-mail: rahmije.topxhiu@uni-pr.edu

1. PËRSHKRIMI I LËNDËS

Lënda “Ekonomiksi i Zhvillimit të Kosovës” prezanton një pamje gjithëpërfshirëse të aspekteve të ndryshme të zhvillimit të Kosovës. Lënda përmban informata dhe njohuri të rëndësishme praktike dhe teorike të zhvillimit të Kosovës në aspektin historik, aktual dhe nga perspektiva e së ardhmes përmes trajtimit të çështjeve të zhvillimit, si faktorët e zhvillimit, treguesit e zhvillimit, trendet aktuale të shumë aspekteve të zhvillimit të Kosovës, si struktura ekonomike dhe perspektiva në të ardhmen, financat dhe politika fiskale, roli i financave të jashtme për zhvillim, integrimet e Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe integrimi të ndryshme rajonale dhe botërore. Një rëndësi e veçantë do të kushtohet edhe reformave strukturale për zhvillim siç është privatizimi i pronës shoqërore dhe ristrukturimi ndërmarrjeve publike.

2. QËLLIMET E LËNDËS

- Qëllimi i lëndës së Ekonomiksit të Zhvillimit të Kosovës është që tu ndihmoj studentëve që të përfitojnë njohuri më të thella për një numër të çështjeve kritike rreth zhvillimit të Kosovës;
- Të kuptojnë pikëpamjet e tradicionale dhe bashkëkohore të zhvillimit;
- Të informohen dhe të analizojnë karakteristikat kryesore të ekonomisë së Kosovës;
- Të dinë se çfarë ndryshimesh institucionale kanë ndodhur gjatë procesit të tranzicionit nga ekonomia socialiste në ekonomi të tregut;
- Të njihen dhe të vlerësojnë rolin e disa faktorëve të zhvillimit të Kosovës gjegjësisht të dinë se cilat janë burimet nacionale dhe

ndërkombëtare për rritje ekonomike, si dhe strukturën ekonomike të vendit.

- Të kuptojnë dhe vlerësojnë se cili është roli i politikave financiare dhe fiskale në promovimin e zhvillimit si dhe rolin e financave të jashtme, investimeve dhe ndihmave për zhvillim.
- Të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e integritit dhe anëtarësimit të Kosovës në integritet rajonale dhe organizata ndërkombëtare;
- Të vlerësojnë se tregu i lirë dhe privatizimi i ekonomisë a janë përgjigje për probleme të zhvillimit, apo qeveria duhet ende të ketë rol qendror për të luajtur në ekonominë e vendit.

3. METODOLOGJIA

- Metoda e punës gjatë dy orëve ligjërata do të përqendrohet në ligjërata dhe në punime seminarike të përgatitura nga studentët dhe të prezantuara gjatë orës së ligjëratave gjegjëse.
- Studentët janë të obliguar që të përgatisin punime seminarike me shkrim dhe ato t'i prezantojnë gjatë orës së ligjëratave.
- Ndarja e temave të seminarit do të bëhet në fillim të semestrit dhe studentët duhet të përgatisin seminarin për orën e temës së ligjëratës të paraparë sipas Syllabusit.
- Gjatë prezantimit të seminarit studentët duhet të nxisin diskutime në mesin e kolegëve të tyre.

4. LITERATURA

- Michael P.Todaro & Stephen C. Smith - “Economic Development”,; Pearson Addison Wesley; England, 2010.
- Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës & Oda Ekonomike e Kosovës, “Kosova – Strategjia e Zhvillimit Ekonomik” 2002.
- “Strategjia e Energjisë e Republikës të Kosovës për periudhën 2009 – 2018” (Rishikimi i strategjisë së energjisë Për periudhën 2005-2015), Republika e Kosovës, Ministria e Energjisë dhe Minierave.
- “Korniza-Afatmesme-e-Shpenzimeve-2016-2018”, Republika e Kosovës, Ministria e Ekonomisë dhe Financave.
- Publikimet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës : “Bruto produkti vendor në qasjen e shpenzimeve 2008 - 2014”, Indeksi i Çmimeve të Konsumit; Ecuritë e tregtisë së Jashtme, si dhe publikimet e tjera të Statistikave ekonomike të ASK.
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës: “Raportet Vjetore 2013, 2014”, Buletinet Mujor , Raporti i Stabilitetit Financiar 8. si dhe buletinet: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë, etj.
- UNDP “Raporti i zhvillimit njerëzor”, dhe raporte të tjera.
- Banka Botërore: Memorandumi ekonomik i shtetit : Zhbllokimi i potencialit për rritje, 2010
- Raporte të ndryshme të institucioneve ndërkombëtare si të FMN,

5. PLANI I MËSIMIT

Java 1	HYRJE - Prezantimi i Syllabusit dhe çështjeve që lidhen me mësimin gjatë semestrit.
Java 2	DISA KONCEPTE KYÇE RRETH EKONOMIKSIT TË ZHVILLIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK - Nocioni dhe kuptimi i zhvillimit - Matësit tradicional të zhvillimit - Pikëpamja e re për zhvillim - Vlerat kryesore të zhvillimit - Qëllimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM- MDG) - Komponentët e rritjes ekonomike
Java 3	DISA MODELE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK - Modelet klasike të rritjes ekonomike - Modeli i Harrod-Domarit dhe Rostow-it - Modeli i Sollow-it - Modeli endogjen i zhvillimit, Teoria endogjene e rritjes. - Disa modele të tjera
Java 4	KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË EKONOMISË SË KOSOVËS - BPV, Të ardhurat kombëtare, indeksi i zhvillimit njerëzor, indeksi i varfërisë, etj - Papunësia- tregu i punës - Varfëria - Inflacioni dhe çmimet, etj.
Java 5	NDRYSHIMET INSTITUCIONALE NGA SISTEMI SOCIALIST NË EKONOMI TË TREGUT - Disa karakteristika të zhvillimit ekonomik të Kosovës në ish - Jugosllavi - Disa karakteristika të tranzicionit në Kosovë - Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore dhe publike- Çështjet dhe zhvillimi
Java 6	DISA NGA FAKTORËT E ZHVILLIMIT EKONOMIK TË KOSOVËS I - Faktori njeri- popullsia dhe burimet njerëzore - Rritja e popullsisë dhe rritja ekonomike- problemet dhe sfidat
Java 7	DISA NGA FAKTORËT E ZHVILLIMIT EKONOMIK TË KOSOVËS II - Resurset minerare të Kosovës - Energjetika - Agrikultura - Të tjera.

Java 8	STRUKTURA EKONOMIKE DHE PERSPEKTIVA NË TË ARDHMEN <ul style="list-style-type: none"> - Sektori i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Kosovë - Politika e transportit - Mjedisi, etj
Java 9	FINANCAT DHE POLITIKA FISKALE PËR ZHVILLIM <ul style="list-style-type: none"> - Sqarime te koncepteve bazë: Politika fiskale , buxheti i shtetit - Lëvizja e madhësisë së buxhetit të shtetit - Struktura e buxhetit të shtetit sipas të hyrave dhe shpenzimeve - Decentralizimi fiskal në Kosovë, etj
Java 10	ROLI I SEKTORIT FINANCIAR PËR ZHVILLIM EKONOMIK <ul style="list-style-type: none"> - Roli i sistemit financiar dhe bankar - Roli i Bankës Qendrore - Roli i bankave komerciale dhe institucioneve të tjera financiare - Nevoja për Bankën Zhvillimore
Java 11	MARRËDHËNIET EKONOMIKE TE KOSOVËS ME BOTËN E JASHTME <ul style="list-style-type: none"> - Sqarimi i disa koncepteve: bilanci i pagesave, llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave, bilanci tregtar, deficitit, suficitit, etj - Karakteristikat e tregtisë së jashtme të Kosovës - Bilanci tregtar-Raporti në mes të importit dhe eksportit - Struktura e importit dhe eksportit dhe partnerët kryesor tregtar, etj.
Java 12	FINANCAT E JASHTME, INVESTIMET DHE NDIHMA <ul style="list-style-type: none"> - Investimet direkte të huaja - Ndihma e jashtme (ndihma zyrtare për zhvillim) - Dërgesat e emigrantëve
Java 13	INTEGRIMET NDËRKOMBËTARE DHE ORGANIZATAT I <ul style="list-style-type: none"> - Integrimi i Kosovës në CEFTA - Anëtarësimi në Fondin Monetar Ndërkombëtar - Anëtarësimi në Bankën Botërore - Anëtarësimi në institucione të tjera Ndërkombëtare
Java 14	INTEGRIMET NDËRKOMBËTARE DHE ORGANIZATAT II <ul style="list-style-type: none"> - Kosova në Marrëveshjet ndërkombëtare. - Kosova dhe Integrimi Evropian
Java 14	PARAPERGADITJE RRETH PROVIMIT

6. METODAT E VLERËSIMIT	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Punimi me shkrim dhe prezantimi 10% ▪ Pjesëmarrja në diskutime dhe prezantime 5% ▪ Provimi final: 85%
--------------------------------	---

Detajet rreth punimit seminarik dhe prazantimit

Studentët do të punojnë punimin me shkrim dhe do ta prezantojnë para profesorit dhe kolegëve të tyre. Me këtë rast ata do të dëshmojnë se:

- Dinë të shfrytëzojnë literaturën akademike;
- Kanë përvetësuar njohuritë teorike krahas prezantimit të shembujve praktik ;
- Dinë të citojnë literaturën e përdorur;
- Dinë të përdorin dhe shfrytëzojnë literaturën, si libra, artikuj në revista shkencore, etj., duke përfshirë edhe literaturën e obliguar të lëndës, etj.

Punimet mund të punohen nga një apo dy studentë së bashku.

Struktura e seminarit

Seminari duhet të ketë:

- Tabelën e përmbajtjes
- Hyrjen
- Aspektet teorike të problematikës së trajtuar
- Rastin studimor-
- Konkluzionet
- Referencat/Fusnotat
- Literaturën
- Listën e shkurtesave

Studentët mund t'i dorëzojnë punimet e tyre në kohën e konsultimeve, apo në e-mail adresën: rahmiye.topxhiu@uni-pr.edu, më së largu **një javë para prezantimit**.

Studentët janë të obliguar që të përgatisin seminare dhe t'i prezantojnë ato për çdo javë.

Rregullat e prezantimit të punimit

1. Studenti gjatë kohës së prezantimit mund ti shfrytëzojë shënimet e veta për të rikujtuar çështjet që i ka punuar, por nuk guxon që t'i lexoj tërë kohën. Është me rëndësi që seminari të prezantohet e jo të lexohet.
2. Me rastin e prezantimit mund të shfrytëzojë projektorin , mirëpo në sllajde duhet të jenë të përfshira vetëm gjërat kryesore, e kursesi i tërë teksti. Largoni tabelat e mëdha nga sllajdet, më mirë i prezantoni me grafik.
3. Koha optimale për zgjatjen e prezantimit është 30 minuta.
4. Para prezantimit të seminarit studentët janë të obliguar që të vijnë në konsultime me prezantime të gatshme.
5. Seminaristët do të duhej që të kyçin studentët e tjerë në seminar duke nxitur diskutime dhe debat të cilat do të vlerësohen shumë.

Informacionet shtesë lidhur me punimin me shkrim dhe prezantimin e tij mund të merren gjatë kohës së konsultimeve.